

**Best Price sh.p.k**  
**Tiranë, Shqipëri**  
**CEL :+355682033883**  
**E-mail:bestbransds2024@yahoo.com**

**04/09/2024**

## **STATUTI I SHOQËRISË TREGTARE**

**Best Price sh.p.k**

**Robert Kadriu** , i datelindjes 15.08.1988, lindur ne Shqiperi dhe banues në Tirane,Shqiperi me Nr. ID I80815112G.

Hartojme Statutin e shoqërisë me përgjegjesi te kufizuar, sipas përcaktimeve të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "*Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare*",i ndryshuar.Me nëshkrimin e këtij statuti, themeluesi mer përsipër të realizojë e të respektojë të drejta dhe detyrimet të mëposhtme:

### **KREU I**

#### **EMRI, ORTAKËT, SELIA, KOHËZGJATJA**

#### **NENI 1**

##### **Emërtimi i shoqërisë**

1.1 Emri i shoqërisë është **Best Price sh.p.k**

Emërtimi i shoqërisë tregtare, kapitali themeltar si dhe emri i ortakut duhet të jenë të përmendura në të gjitha aktet dhe dokumentat që nxjerr kjo shoqëri dhe që ju drejtohen të tretëve.

1.2 Shoqëria e emërtuar **Best Price sh.p.k** (më poshtë e quajtur shoqëria ) është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e krijuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria është themeluar sipas ligjit Nr. 9901 , datë 14.04.2008 "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare* ", i ndryshuar dhe fiton personalitet juridik pas regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar Shqiptar të mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

#### **NENI 2**

##### **Ortakët**



Ortakët e shoqërisë **Best Price sh.p.k** do të jenë :

- **Robert Kadriu** , i datelindjes 15.08.1988, lindur ne Shqiperi dhe banues në Tirane,Shqiperi me Nr. ID I80815112G, zotëron 100% (nje qind përqind) të vlerës së kapitalit të shoqërisë.

### **NENI 3** **Selia**

3.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Tirane, : Njesia Bashkiake Kamez, Vore, Rruga Kosova, Z.Kadastrale 2066, Kati i I. ,Tirane.

3.2 Shoqëria mund të hap zyra përfaqësimi, degë dhe/ose filiale të marrë pjesë në shoqëri të tjera, të kryejë aktivitete në vende të tjera , qoftë brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

### **NENI 4** **Kohëzgjatja**

Kohëzgjata e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë e pakufizuar. Asambleja e Ortakëve mund ta kufizojë ose ta zgjasë afatin e veprimtarisë së Shoqërisë.

### **NENI 5** **Vula**

Shoqëria ka vulën me emrin e saj.

## **KREU II** **OBJEKTI, KAPITALI, TRANSFERIMI I KUOTAVE**

### **NENI 6** **Objekti**

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj ushtrimin e aktiviteteve si më poshtë:

- Tregfi me shumice dhe pakice te produkteve ushqimore dhe kozmetike, detergjenteve, import-export.

Çdo veprimtari tjeter qe nuk ndalohet me ligj.



## **NENI 7** **Kapitali**

7.1 Kapitali themeltar i regjistruar i Shoqërisë është 300.000 (njëqind mijë) Lek i ndare ne nje kuote, zoteruar nga ortakët si meposhte :

7.2 Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre si mëposhte:

- **Robert Kadriu** , i datelindjes 15.08.1988, lindur ne Shqiperi dhe banues në Tirane, Shqiperi me Nr. ID I80815112G, zotëron 100% (nje qind për qind) të vlerës së kapitalit të shoqërisë, nje kuote.

7.3 Kapitali është nënshkruar dhe shlyer tërësisht nga ortakët e shoqërisë, sipas pjesëve përkatëse të përcaktuara.

7.4 Përgjegjësia e secilit ortak shtrihet deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin e shoqërisë.

7.5 Kapitali i shoqërisë mund të rritet në të ardhmen, nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së kuotave të reja nga ortakët e rinj, vetëm me vendim unanim të Asambles së Ortakëve , ku do të miratohet si rritja e kapitalit themeltar ashtu dhe hyrja e ortakëve të rinj. Ky kapital mund të shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit të gjithë ortakëve.

7.6 Zvogëlimi i kapitalit te shoqërisë do të realizohet duke u bazuar në dispozitat e veçanta që parashikohen nga Ligji 9901. date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

7.7 Kapitali i shoqërisë do te perbehet nga kapitali themeltar, mjetet e xhiros, detyrimet e ortakëve huara dhe instrumenta te tjera, dhe te tjera pasuri te nevojshme te luajtshme apo te paluajtshme per ushtrimin e aktivitetit te shoqërisë.

## **NENI 8**

### **Transferimi i kuotave dhe e drejta e përparësisë**

8.1 Kuotat e cdo anëtari përputhen me pjesen e tyre ne kapitalin e shoqërisë. Kuotat e shoqërisë janë të transferueshme midis ortakëve të shoqërisë ose të tretëve në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së aktivitetit të shoqërisë. Anëtarët e shoqërisë kanë përparësi për blerjen e kutoave përpara personave të tretë jashtë shoqërisë.

8.2 Nëse ndonjë nga ortakët dëshiron të transferojë ose të shesë një pjesë ose të gjitha kuotat e tij atëherë ai duhet t'i drejtojë një kërkesë me shkrim Administratorit duke saktësuar çmimin e shitjes, i cili duhet të jetë i arsyeshëm dhe të jetë i njëjtë me atë që do t'i ofrohet dhe një personi të tretë jashtë shoqërisë si dhe të dhënat e blerësit. Administratori jep përgjigje brënda 30 ditëve nga data



e njoftimit dhe duhet t'ua transmetojë ortakëve të tjerë këtë kërkesë dhe ortakët e tjerë duhet të japin një përgjigje brenda 3 muajve. Edhe e drejta e përparisë për transferimin ose shitjen e kuotave duhet të ushtrohet me shkrim duke ju drejtuar Administratorit.

8.3 E drejta e përparisë për transferimin ose shitjen e kuotave është në propocion me kuotat që zotëron secili prej ortakëve në këtë shoqëri. Administratori pasi ka kaluar afati 3 muajsh, brenda 30 ditëve i komunikon ortakut që shet kuotat e tij vendimin e ortakëve të tjerë për të blerë të gjitha ose pjesërisht kuotat e tij.

8.4 Në rast se kuotat nuk shiten brenda shoqërisë, atëherë kuotat brenda 90 ditëve i orfrohen personave të tretë jashtë shoqërisë. Transferimi dhe shitja e kuotave duhet të bëhet me akte noteriale dhe një kopje e këtij akti duhet të depozitohet në librin e Ortakëve.

8.5 Të gjitha transferimet e kuotave kanë efekt mbi shoqërinë që nga momenti i regjistrimit në librin e Ortakëve dhe në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Kuotat me vlerë nominale 1.000 leke janë të pandashme. Në ratet e bashkëpronësisë veprohet sipas ligjeve.

### **KREU III**

#### **ORGANET DREJTUESE**

#### **NENI 9**

Shoqëria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ushtron aktivitetin e saj pas regjistrimit si subjekt tatim pagues.

Organet kryesore të Shoqërisë janë:

- Asambleja e ortakëve,
- Administratori

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit e organeve drejtuese rregullohet si me poshtë.

#### **NENI 10**

#### **Asambleja e Ortakëve**

##### **10.1 Funkzioni dhe Kompetencat :**

10.1.1 Në përputhje me legjislacionin shqiptar, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve e thirrur rregullisht, përfaqëson të gjithë Ortakët e shoqërisë dhe është organi më i lartë vendimarrës i shoqërisë. Në përputhje me legjislacionin shqiptar, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të marrë vendimet e mëposhtme, por pa u kufizuar vetëm në to:



- a) Percaktimin e politikave të biznesit;
  - b) Emërimin dhe shkarkimin e Administratorit (eve);
  - c ) Emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël;
  - d) Rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;
  - e) Zbatimin dhe miratimin e pasqyrave financiare për llogaritë vjetore, të administrimit dhe të raporteve të mbikëqyrjes;
  - f) Miratimin e rregullave procedurale në lidhje me mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve;
  - g) Miratimin e shpërndarjes së fitimit vjetor;
  - h) Miratimin e skemës së kompesimit për Administratorin, Likuiduesin, dhe ekspertët kontabël;
  - i) Ristrukturim, prishjen, transformimin, bashkimin, likuidimin e shoqërisë ose riorganizimin e Shoqërisë në ndonjë formë tjetër Shoqërie;
  - j) Marrjen e të gjitha masave me qëllim që të sigurohet që Shoqëria të ketë kapital dhe asete të mjaftueshme për ushtrimin e aktiviteti dhe përmbushjen e detyrimeve kundrejt të tretëve ;
  - k) të hipotekojnë, lenë peng dhe vendosin çdo barrë mbi asetet e veta dhe të lidhin çfarëdo marrëveshje financiare me çdo palë financuese, me kusht që hipoteka , pengu apo barrët e tjera, po ashtu si dhe marrëveshjet përkatëse financiare, të shërbejnë për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në nenin 4;
  - l) Krijimin, mbylljen dhe/ose prishjen e degëve, zyrave të përfaqësimit dhe filialeve;
  - o) çdo çështje tjetër që përcaktohet nga ligji dhe nga ky statut;
- 10.1.2 Çdo Ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e Asamblesë, me të drejtën e votës në raport me numrin e kuotave të zotëruara në kapitalin e Shoqërisë. Çdo ortak mund të përfaqësohet në vendimarrje nga një ortak tjetër, nga bashkëshorti(ja) ose nga çdo person tjetër, me kusht që përfaqësuesit të jenë të pajisur me prokurë për këtë qëllim.

## **10.2 Thirrja e Asamblese**

10.2.1 Administratoret, sipas gjykimit të tyre të lire ose me kekesen e një dhe/ose me shume Ortakeve të cilët përfaqësojnë të paktën 5 % të kapitalit të Shoqërisë , dhe/ose eksperti kontabel i autorizuar , nese ka, dhe/ose likuiduesit kanë të drejtë të thërrasin Asamblene e Përgjithshme të Ortakeve.Ortakeve duhet t'u dergohe nje njoftim me shkrim per mbledhjen me ane te postes se regjistruar



apo me e-mail, jo me pak se 7 dite perpara dates se mbledhjes, qe permban te dhenat per arsyen e mbledhjes, vendin, daten dhe oren e saj.

10.2.2 Verifikimi i njoftimit te mbledhjes nuk eshte i nevojshem nese te gjithë Ortaket jane te pranishem apo jane te perfaqesuar , ne perputhje me nenin 10.2.1.

### **10.3 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme**

10.3.1 Asambleja e Përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ligji, statuti dhe sa herë është e nevojshme për të mbrojtur interes të shoqërisë.

10.3.2 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mblidhet nëse:

a) rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare;

b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kane një vlerë më të lartë se 5 % të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

c) shoqëria , brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj propozon të bleje nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 % të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e dundit financiare të certifikuara.

- Asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

10.3.4 Asambleja e përgjithshme mund të zhvillohet në selinë e shoqërisë, ose online pas realizimit të komunikimit në adresën elektronike të dhënë nga ortakët.

### **10.4 Kuorumi**

10.4.1 Në rastin e marrjes se vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave.

10.4.2 Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendos për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të cilësuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shpresë, apo mjete elektronike.





## **10.5 Marra e vendimeve**

10.5.1 Asambleja e Përgjithshme vendos me tri te katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës në rastet kur kërkohet :

- a) ndryshimi i statutit,
- b) zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit të regjistruar,
- c) shpërndarja e fitimeve riorganizimi,
- d) prishja e shoqërisë.

10.5.2 Me përjashtim të rasteve të parashikuara sa më sipër në pikën 10.5.1, për të gjitha pikat e tjera të përcaktuara në pikën 10.1.1, Asambleja e Përgjithshme do të vendosë me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

## **NENI 11 ADMINISTRATORI**

11.1 **Robert Kadriu** , i datelindjes 15.08.1988, lindur ne Shqiperi dhe banues në Tirane,Shqiperi me Nr. ID I80815112G , me afat 5 vjecar.

11.2 Administratori i vetëm do të qëndrojë në këtë detyrë për një periudhë 5 vjeçare nga dita e depozitimit të statutit në QKB.

## **NENI 12 Kompetencat e administratorit**

12.1 Administratori i vetëm i Shoqërisë ka të drejtë e detyrohet të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë.Ai ushtron të gjitha kompetencat sipas përcaktimeve të nenit 95 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

12.2 Administratori i vetem i ka te gjitha te drejtat e fuqite per drejtimin e zakonshem te Shoqerise, me qellim arritjen e objektivave te saj.

12.3 Administratori i Shoqërisë ka te drejtë të emërojë pëfaqësues të posaçëm dhe të delegojë kompetencat e tij.

12.4 Administratorit te vetem i takon firma e lire dhe perfaqesimi i Shoqerise ndaj te treteve ne veprime, procedura dhe seance gjyqesore, si dhe pajtime dhe kompromise, pasi te kete marre vendimin e Asamblese.



12.5 Administratori është përgjegjës, sipas rastit ndaj shoqërisë ose të tregëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit apo dëme të kryera gjatë ushtrimit të detyrës.

12.6 Kompetencat kryesore të Administratorit të shoqërisë janë:

- Të hartojë planet e llogarive ekonomike.
- Të hartojë akte normative që përcaktojnë raportet në gjirin e shoqërisë duke përfshirë kuadrin dhe personelin.
- Të përfaqësojë Shoqërinë me të tretet në të gjithë veprimtarinë e saj.
- Të përcaktojë strukturat e aparatit të shoqërisë dhe të krijojë organe të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të Shoqërisë.
- Të përzgjedhë ekspertët kontabel dhe anëtarët e komisionit të likuidimit.
- Të përcaktojë numrin e punonjësve të shoqërisë dhe pagat e tyre.
- Të vendosë rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve të ndryshme (të vecanta), etj;
- Të përfaqësojë shoqërinë në regjistrin e pronës sipas këtij statuti.
- Të mbikqyrë dhe të zbatojë veprimtaritë dhe politikat tregtare të Shoqërisë dhe vendimet e Asambles së Ortakëve ;
- Me kërkesë të asambles së ortakëve , të ndermarrë masa të cilat janë kompetencë e kësaj të fundit, të propozojë vendimet që do të miratohen nga Asambleja e ortakëve dhe t'i zbatojë këto vendime ;
- Të sigurojë që Shoqëria respekton ligjin e zbatueshëm dhe standartet kontabel;
- Të kryejë të gjitha veprimet në lidhje me administrimin e aktivitetit tregtar të Shoqërisë;
- Të sigurojë dokumentet dhe librat kontabel të Shoqërisë të mbahen në rregull dhe me saktësi;
- Të thërrasë një mbledhje të Asambles së Përgjithshme kur e vlersojnë të nevojshme për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë;
- Të përgatitë dhe nënshkruaj pasqyrat financiare vjetor të Shoqërisë, pasqyrat financiare të konsoliduara, të cilat bashkë me propozimin për shpërndarjen e fitimit i paraqiten për miratim Asambles së ortakëve;
- Të kryej të gjitha regjistrimet dhe publikimet e detyrueshme në lidhje me Shoqërinë , sipas parashikimeve të ligjit të zbatueshëm;
- Të miratojë hapjen e çdo procedurë ligjore ose mbylljen e tyre;

**KREU IV**  
**KUSHTET EKONOMIKE**  
**NENI 13**





Shoqëria është pronare, përdoruese dhe disponuese e pasurisë së saj. Ajo vepron në regjistrin e pronës si çdo person tjetër juridik në Shqipëri; mund të blejë, të shesë, të japë në përdorim, të ngarkojë me barrë për detyrime ndaj të tretëve ose për kredi bankare, etj.

#### **NENI 14**

Shoqëria ka llogarine e saj rrjedhese, si dhe librin e saj të llogarive në baze të kërkesave të ligjit për kontabilitetin e dispozitave të tjera fiskale. Transferimi i mjeteve monetare dhe transaksionet financiare do të kryhen në baze të kriterëve të caktuar nga Banka e Shqipërisë.

#### **NENI 15**

Veprimet ekonomiko-financiare të shoqërisë nisin; vitin e parë në momentin e regjistrimit në QKR dhe në organet tatimore e mbyllen në 31 dhjetor të po atij viti, ndërsa vite të tjera në 1 Janar dhe mbyllen në 31 Dhjetor të çdo viti. Në fund të çdo periudhe ushtrimore hartohet bilanci kontabel sipas ligjeve në fuqi. Bilancet periodike (mujore, tremujore, gjashtëmujore) miratohen e nënshkruhen nga administratori i shoqërisë. Bilancet vjetore miratohen nga asambleja e ortakëve e nënshkruhen nga administratori dhe depozitohen në QKR e në Tatim Taksa. Llogaritë vjetore, inventaret, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e vecanta të hartuara nga Administratori dhe eventualisht eksperti kontabel i autorizuar, miratohen nga ortakët.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda 3 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Kontrolli i shoqërisë kryhet nga një ekspert Kontabel i Autorizuar, i emëruar për tre vite financiare mundësi rizgjedhjeje, nga ortakët.

Shkarkimi i Ekspertit Kontabel të Autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emërimi, në rast se vërehen gabime ose bëhet e pamundur kryerja e detyrës.

#### **NENI 16**

Fitimi neto i realizuar, pasi janë zbritur rezervat ligjore deri 5% të fitimit të cilat do të krijohen në shoqëri deri shumën 10% të kapitalit dhe tatimet mbi fitimin, mbetet në përdorim të ortakëve të cilët vendosin për përdorimin e tij.

#### **NENI 17**



Ne rastet kur ortaket jane debitore per kapital te paderdhur sipas % te pjesemarjes ne kapital, fitimi neto do te kaloje per shlyerje te detyrimit deri ne masen e plotesimit te % te pjesemarjes.

## **KREU V** **MARRËDHËNIET E PUNËS**

### **NENI 18**

Maredheniet e punes ne kete shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk parashikohen ne kete statut do zbatohen dispozitat e Kodit te Punes ne Republiken e Shqiperise. Mosmarreveshjet e punonjesve me shoqerine do te zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert zgjidhja behet ne gjykatën shqiptare. Punonjesit e emeruar nuk marrin pjese ne ndarjen e fitimit te realizuar nga shoqeria gjate aktivitetit te saj, nese ne kontrate nuk eshte parashikuar ndryshe. Per punen e kryer punonjesit marrin page sic eshte parashikuar ne kontrate.

## **KREU VI** **DISPOZITA TË VEÇANTA** **NENI 19**

Shoqeria mund te priset ne cdo kohe dhe per cfaredo lloj shkakut, si ne rast falimentimi, privim te drejtave per te ushtruar aktivitet tregëtar, forca madhore dhe faktore te tjere qe nuk varen nga ortaket.

Shoqeria hyn ne fazen e likujdimit qysh ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi, Ortaket emerone nje ose disa likujdatore, te cilet i paraqesin atij raportin mbi gjendjen e Aktivit dhe Pasivit te Shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe afatin e nevojshem te perfundimit te tyre.

Ne fund te procesit te likujdimit, Ortaket vendosin mbi Bilancin perfundimtar financiar. Mbi aktin e rregullshmerise se punes se likujduesit dhe mbyllje si pjese e likujdimit.

Mbas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeve te kapitalit themeltar tek kontribuesi perkates, likujdatori ndan kapitalet e mbetura per ortaket.

### **NENI 20**



Mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne shoqeri me të tretët, zgjidhen me pajtim, ne të kundërt palët i drejtohen Gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

#### **DISPOZITA TE FUNDIT**

#### **NENI 21**

Shoqeria konsiderohet e krijuar ne perputhje me nenet e ketij statuti dhe aktit themelimit bashkelidhur dhe fiton personalitetin juridik me regjistrimin ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, Tirane, ne baze te ligjit nr.9723 date 03.05.2007.

#### **NENI 22**

Per sa nuk eshte parashikuar ne kete Statut do ti behet referim ligjit Nr 9901 date 14/04//2008"*Per Tregetaret dhe Shoqeriste Tregetare*", i ndryshuar si dhe legjislacionit koherent.Ndryshimet dhe plotesimet e ketij statuti behen ne te njejten menyre e procedure me te cilen nxirret vete statuti.

#### **NENI 23**

Ky statut u përpilua nga Ortakët themelues duke shprehur vullnetin e tyre të plotë e të lirë.

Ai u përpilua në katër kopje autentike, njëkopje për t'u depozituar në QKB nga një kopje për secilin prej ortakëve dhe nje kopje mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

**Best Price sh.p.k**

**ORTAKU I VETEM**

**ROBERT KADRIU**

